

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Shërbim lyerje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave për Sptatlin Universitar të Traumës”. Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 98316000-1, Shërbime lyerjeje

Vlera e fondit limit: 20,827,524 (njëzete milion e tetëqind e njëzete e shtate mijë e pesëqind e njëzete e katër)lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

- 2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate shërbimi per te deshmuar pervojen e meparshme vlere totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP-3A Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS-1A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS-2A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS-4A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-14A Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar ne shërbimin qe do te realizohet sipas objektit te prokurimit. Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-3A	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.	Mur me tulla te lehtësuara deri - 3 m, L.L.P. M-25 Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires Veshje muri me MDF Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Kasete shkarkimi me llamarine xingat Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120 Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Mbulim çatie me panele sandwich Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura Nenshtrese rere Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit Nenshtrese zhavori Shtrese rere Shtrese betoni C 7/10 Shtrese me pllaka mermeri t=3cm Shtrese me pllaka porcelanat Shtrese me pllaka graniti t=2cm Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Veshje me pllake majolike Patinim muri allçi (stuko) Patinim tavani allçi (stuko) Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Veshje fasade me pllaka mermeri Veshje fasade me alukobonde Suvatim me grafiato h > 4 m Plintuse pllake grez Veshje tavani me kartonxhes Veshje muri me kartonxhes Patinim muri me stuko Suvatim shpatullash ne rikonstrukcion Suvatim me llaç-çimento Sherbetisje e bojatisje me gelqere Boje vaji siperfaqe druri Boje vaji siperfaqe metalik Boje hidroplastike cilesi e larte Veshje muri me gips kundra zjarrit F.V Shtrese me linoleum antibakterial (mur ose dysHEME) F.V Korimano metalike Pastrim ulluqe shkarkimi h>8m Pastrim tarrace Riparim catie llamarine Shtrim me rezine	A (0-20 milionë lekë)

		Riparim Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi etj;	
NS-1A	Punime për prishjen e ndërtimeve.	Prishje mur tulle pa pastrim Prishje shtresa betoni Prishje suvatim i jashtem Prishje suvatim muri i brendshem etj;	A (0-20 milionë lekë)
NS-2A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm F.V bide porcelan F.V vaske dushi F.V bolier 100 l F.V Saraçineske PPR 1/2" F.V Saraçineske PPR 3/4" F V rezervuari zingato 5000 litra F V rezervuari zingato 2000 litra F V rezervuari zingato 500 litra F V bolier 80 liter, uje te ngrohte F V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar F.V Tuba e rakorderi PVC FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm F.V WC allafrenga F.V hydrante Ø 100 mm F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 200 F.V Lavamane porcelani F.v WC porcelani importi per PAK F.v Lavaman porcelani importi per PAK F.v lavaman porcelani i vogel F.v kasete wc plastike F.v kasete wc porcelani F.v tub fleksibel 50 cm F.v tub shkarkimi fizarmonike F.v galexhant kasete wc F.v galexhant depozite F.v grup dushi F.v grup lavamani F.v grup lavamani tip gjel Fv Rubinet lavamani me shtypje F.v koke grup dushi e lavamani F.v rubinete 1/2" F.v valvol moskthimi 1/2" Fv Pilete lavamani Fv Kundra valvol dushi Konstatim difekte hidraulike etj;	A (0-20 milionë lekë)
NS-4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires Veshje muri me MDF Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Kasete shkarkimi me llamarine xingat Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120 Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	A (0-20 milionë lekë)

		Mbulim çatie me panele sandwich Shtrese me pllaka mermeri t=3cm Shtrese me pllaka porcelanat Shtrese me pllaka graniti t=2cm Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Veshje me pllake majolike Patinim muri allçi (stuko) Patinim tavani allçi (stuko) Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Veshje fasade me pllaka mermeri Veshje fasade me alukobonde Suvatim me grafiato h > 4 m Plintuse pllake grez Veshje tavani me kartonxhes Veshje muri me kartonxhes Patinim muri me stuko Suvatim shpatullash ne rikonstruksion Suvatim me llaç-çimento Sherbetisje e bojatisje me gelqere Boje vaji siperfaqe druri Boje vaji siperfaqe metalik Boje hidroplastike cilesi e larte Veshje muri me gips kundra zjarrit F.V Shtrese me linoleum antibakterial (mur ose dysHEME) Riparim Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi Dritare d/alumini pa xham,me mbushje d/a. Dyer d/alumini me mbushje element d/a. Dyer d/alumini tek xh. F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. F V dritare d/alumini plastike me dopio xham F V dyer d/alumini plastike me dopio xham Grila d/alumini me kanate per dritare. Grila d/alumini me role per dritare. Riparim dyer dritare druri Riparim dyer dritare duralumini Riparim dyer dritare plastike Riparim dyer metalike Riparim dyer te blinduara importi F.v xham i thjeshte F.v xham akulli F.v dopio xham F.v dopio xham akulli F.v dopio xham akulli me rrjete Riparim rafte, tavolina, karrige F.v brave dere druri F.v brave dere duralumini F.v brave dere plastike F.v brave elektrike F.v fisheke brave per dyer druri F.v fisheke brave per dyer duralumini F.v fisheke brave per dyer plastike F.v doreza brave per dyer druri F.v doreza brave per dyer duralumini F.v doreza brave per dyer plastike F.v doreza brave per dyer metalike F.v doreza te rrumbullaketa F.v mentesha per dyer druri F.v mentesha per dyer duralumini F.v mentesha per dyer plastike F.v dryn per dyer F.v mentesha me dy hapje per dyer druri (tip kauboy)	
--	--	--	--

		F.v mentesha me dy hapje per dyer duralumini (tip kauboy) F.v mentesha me dy hapje per dyer plastike (tip kauboy) F.v shula vertikal per dyer druri F.v shula vertikal per dyer duralumini F.v shula vertikal per dyer plastike F.v shula horizontal per dyer druri F.v shula horizontal per dyer duralumini F.v shula horizontal per dyer plastike Riparim grila dritaresh F.v rrjete kunder insekteve Punime Saldimi Fv kendore alumini per dyer etj;	
NS-14A	Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V Portollampa norm 10 A F.V priza shuko universal F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54 F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A F.V Çeles 1 polar 220V 10A F.V Çeles 2 polar 220V 10A F.V. Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A F.V. Ndricues tip spot me llampa fluoreshente,2x18w F.V percjelles PPV Ø 2x1.5 mm2 F.V Çelesa e priza 10 A F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim F.V Siguresa ~ 25 A F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A F.V. Ndricues fluoreshent 2x36w,IP40 F.V. Ndricues projektor me llampe SAP-T 250w F.V. Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40w, F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x18w F.V. Ndricues plafoniere brace 1x40W F.V. Ndricues plafoneier muror 1x60w F.V. Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40 F.V. Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40 F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A F.vNdricues plafonier led D-20/20w IP-65 F.vNdricues incaso led 60x60/40w F.vNdricues jashte murit led 60x60/40w F.v Ndricues mural F.v Ndricues rrethor LED plafonier, 25W, IP20 F.v Ndricues incaso 4x18 W IP20, komplet me llampa T8 dhe drosel elektronik F.v Sensor IR me shfaqje, te montuar ne tavan te varur, 230V AC 1000W F.v Ndricues plafonier led D-20/14w Llampë LED, 15W, E27, 3000K, 25000 orë pune Prize zgjatuese 4, 5, 6 vendeshe Llampa LED, 60 W,4800 lm, 6400 K, T160, 30000 ore pune Llampa led L=120cm	A (0-20 milionë lekë)

		Llampa led L= 60cm Transformator për llamba LED, 60W Transformator, 12V, 2.5A/ 30W Transformator, 12V, 33.33A/ 400W Shirit ndriçimi LED, 14.4W-60LED-5050-3000K12V DC IP20 Kanaline plastike 60x40mm Kanaline plastike 15x10mm F.v Kanaline me ngjitje 40x25mm F.V celsa e priza ndricimi 2 polare brenda murit F.V portollampa te zakonshme F.V automat elektro magnetik 1 fazore 16 A F.V automat elektro magnetik 1 fazore 25 A F.V automat elektro magnetik 1 fazore 32 A F.V automat elektro magnetik 3 fazore 32 A F.V automat elektro magnetik 3 fazore 63 A F.V automat elektro magnetik 3 fazore 125 A F.V llampe Ndricesi Luminishent 18 W me 13000 ore pune F.V llampe Ndricesi Luminishent 18 W te gjate me 13000 ore pune F.V llampe Ndricesi Luminishent 18 W te gjate dhe te holle me 13000 ore pune F.V llampe Ndricesi Luminishent 36 W me 13000 ore pune F.V llampe Ndricesi Luminishent 36 W te gjate me 13000 ore pune F.V llampe Ndricesi Luminishent 36 W te gjate dhe te holle me 13000 ore pune F.V Starte ndricuesish Luminishent 18 W F.V Starte ndricuesish Luminishent 36 W F.V Drozel ndricuesish Luminishent 18 W F.V Drozel ndricuesish Luminishent 36 W F.v Llampe prozhektori halogjene 500 w me 13000 ore pune F.v Llampe Prozhektori LED 75 w me 13000 ore pune F.V rezistence Buljeri F.V Reostat Buljeri F.V Salvavite 1 fazore 25 A F.V Salvavite 1 fazore 32 A F.V Salvavite 1 fazore 63 A F.V Salvavite 3 fazore 20 A F.V Salvavite 3 fazore 25 A F.V Salvavite 3 fazore 32 A F.V Salvavite 3 fazore 63 A F.v Spine me Tokezim F.v Suporte priza 3 mudul F.v Suporte priza 4 mudul F.v Suporte priza 6 mudul F.v Kapake priza 3 mudul F.v Kapake priza 4 mudul F.v Kapake priza 6 mudul F.v Percjelles Elektrik 3 x 2.5 mm2 F.v ndricues Prozhektor 500 w me Llampe halogjene F.v ndricues Prozhektor 200 w me Llampe led per ambient te jashtem F.v Role Korposkulare 25 A Konstatim difekte elektrike etj.	
--	--	--	--

2.3.3 Një punësim minimalisht prej **20 (njëzetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndertimi	1
Hidraulik	1
Elektricitist	2
Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)	1
Murator/Suvatues	2
Pllakashtrues	1
Specialist gipsi	1
Punonjes për dyer dritare	2
Bojaxhi	1
Shofer	1

2.3.6/1 Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi,

(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

- 2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për “Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” si dhe për “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH DIN EN UNI **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH DIN EN UNI **ISO 14001-2015 e perditesuar** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH DIN EN UNI **ISO 45001:2018 e përditësuar**, (SSH DIN EN UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- “b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis te projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion me kapaciteti mbajtës min 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Pajisje niveluese shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Depozite uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Skela	m2	150	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme

për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në detyren projektimit bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.